



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 379/3 Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 177 , Datë 13 / 09 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.37 Regj., datë 15.03.2018, të subjektit ankues E Sh, kundër Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural¹, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*” dhe “*të bindjeve politike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, E Sh në vitin 2010 ka lidhur marrëdhëniet e punës me Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR-në). Përgjatë viteve 2010-2013 ka qenë në funksione të ndryshme, si: asistente e Drejtorit të Përgjithshëm, specialiste tek Burimet Njerëzore dhe inspektore tek Drejtoria e Aprovimit të Projekteve. Me datë 27.11.2013 është emëruar në pozicionin e Drejtores së Drejtorisë së Ekzekutimit të Pagesave, pranë AZHBR-së³.

Me shkresën me nr.1096/1 prot., datë 02.02.2017 të Ministrisë së Financave është miratuar propozimi i AZHBR-së⁴ për caktimin e znj.E Sh si nëpunës zbatues përgjegjës për pagesat dhe transfertat buxhetore si dhe fondet e BE-së për AZHBR-në.

Me shkresën me nr.95 prot., datë 11.01.2018 të Drejtores së Shërbimeve Mbështetëse, subjektit ankues i është komunikuar akti i konstatimit të përfundimit të marrëdhënies së punësimit, në të cilin citohet se znj.Sh nuk plotëson kriteret e vendosura nga ligji për ushtrimin e detyrës funksionale si nëpunës zbatues i njësisë publike.

¹Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën AZHBR.

²Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën: KMD.

³Me aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.1272/96, datë 22.05.2017 të Departamentit të Administratës Publike është deklaruar nëpunëse civile për pozicionin Drejtor I Drejtorisë së Ekzekutimit të Pagesave, në AZHBR.

⁴Shkresa me nr.149 prot., datë 25.01.2017.

Subjekti ankues pretendon se largimi i saj nga puna është bërë në shkelje flagrante të së drejtës për punë. Ajo shprehet se: “... AZHBR e ka diskriminuar atë për shkak të gjendjes së saj arsimore dhe për prezumim nga drejtuesit e rinj të bindjeve politike të kundërta me drejtuesit aktualë të institucionit. ...Në fakt unë nuk i përkas asnjë partie pasi kam punuar në këtë institucion me të gjitha partitë që kanë qenë në pushtet ndonjëherë”.

Në përfundim të ankesës, znj.Sh kërkon konstatimin e diskriminimit nga ana e AZHBR-së, për shkak sipërcituar dhe rikthim në vendin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁵, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

1. Me shkresën menr.343/2 prot., datë 28.03.2018 iu kërkua informacion⁶ subjektit AZHBR, kundër së cilit ishte ankuar znj.Sh.

⁵Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

- ⁶Kërkesat e Komisionerit ishin specifikuat: “Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Kopje të kontratës së punës të znj.E Sh.
- Kopje e vlerësimit të punës të subjektit ankues, nëse ka.
- Informacion lidhur me performancën e punës së saj, nëse ka.
- Informacion se cilat janë detyrat e përcaktuara për pozicionin që mbante ankuesja.
- Kriteret që kërkohen për pozicionin e punës si Drejtor në Drejtorinë e Ekzekutimit të Pagesave, pranë AZHBR-së.

Me shkresën me nr.984/1 prot., datë 10.04.2018, AZHBR-ja ka informuar Komisionerin se: “Znj.Sh nuk ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të arsimit, të kërkuara për këtë pozicion pune, sipas përshkrimit të punës. Prezumimi se ankesja është diskriminuar për bindje politike është i pabazuar pasi në asnjë moment, institucioni ynë nuk ka diskriminuar në asnjë lloj forme punonjësit, lidhur me bindjet apo anëtarësimin e tyre në partitë politike, si një e drejtë e njohur dhe e lejuar nga ligji”.

Lidhur me largimin e nëpunëses, znj.Sh AZHBR-ja ka informuar Komisionerin se: “Nga analiza e strukturës, në mbështetje të Urdhërit të Kryeministrit nr.190, datë 06.11.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AZHBR-së”, si dhe duke shqyrtuar përshkrimin e ri të punës, për pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Ekzekutimit të Pagesave, ku përcaktohet se kriteri i arsimit është: “Arsimi i Lartë Universitar në Shkenca Ekonomike, profili Ekonomiks/Financë/Kontabilitet/Financë-Bankë.Masteri shkencor dhe Bachelori të jenë në të njëjtën fushë”. Komisioni i Ristrukturimit, konstatoi se:

- Znj.Sh nuk plotëson kriteret e veçanta të punës për këtë pozicion pune, pasi zotëron diplomë: “Master i Shkencave” (sistemi 4-vjeçar) në degën Gjeografi, në Fakultetin e Histori-Filologjisë, në UT. Gjithashtu zotëron diplomë Master Profesional në degën “Teknologji të Avancuara në Hortikulturë”, në fakultetin e Bujqësisë së Mjedisit, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, si dhe Master Profesional në degën “Ekonomi dhe Agrobiznes”, profili Ekonomi dhe Politikë Agrare, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Mbështetur në nenin 12 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, të ndryshuar, pika 1, përcaktohet: “Nëpunësi zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në varësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike dhe pikës 3/1 ku përcaktohet se: “Në njësitë publike të ndërtuara me më shumë se dy nivele vartësie, punonjësit e financës, në struktura përgjegjëse për financat, të vendosur në nivelet e poshtme të vartësisë konsiderohen punonjës të deleguar të nëpunësit zbatues të njësisë nga varen.”

-
- Informacion nëse në vend të znj.Sh është emëruar një punonjës/e tjetër.Nëse po, një kopje të procedurës për marrjen e tij/saj në punë.
 - Një kopje e dosjes personale të personit të emëruar në vend të znj.Sh.
 - Kopje e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me znj.Sh.
 - Informacion nëse ankesja e ka kundërshtuar shkresërisht pranë AZHBR-së largimin nga puna. Nëse po, një kopje të shkresës së ankeses, si dhe të shkresës kthim përgjigje nga ana e Juaj.
 - Informacion nëse ankesja e ka kundërshtuar gjyqësisht largimin nga puna. Nëse po, një kopje të kërkesë padisë, nëse dispononi.
 - Një kopje të Rregullores së brendshme të AZHBR-së.
 - Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje”.

Punonjësit e financës të vendosur në nivelet e poshtme të vartësisë, duhet të kenë përfunduar të paktën studimet e ciklit të parë në shkencat ekonomike dhe të raportojnë në mënyrë të dyfishtë tek nëpunësi zbatues i njësisë nga varen dhe nëpunësi autorizues përkatës”.

AZHBR informon se referuar sa më sipër, nga administrimi i dosjes së znj.Sh, rezulton se nuk plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, si dhe në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të mbajtur pozicionin e Drejtorit të DEP pranë AZHBR-së. Bashkëngjitur janë dërguar kopje të dosjeve personale të subjektit ankues znj.E Sh si dhe të znj.J Sh⁷, e cila është nëpunësja e emëruar në vend të subjektit ankues, sipas shkresës së DAP-it “Transferim për shkak të ristrukturimit të Institucionit”.

2. Me shkresën nr.625 prot., datë 07.04.2018 Komisioneri i ka kërkuar dokumentacion shtesë” AZHBR-së:

- Kopje të vendimit nr.277 prot., datë 30.01.2018, cituar në shkresën e AZHBR-së me nr. nr.984/1 prot., datë 10.04.2018.
- Kopje të strukturës së vjetër të AZHBR-së (para ndryshimit), ku të pasqyrohen kriteret e kërkuara dhe detyrat për pozicionin që mbante ankuesja. (Drejtores në Drejtorinë e Ekzekutimit të Pagesave, pranë AZHBR-së).
- Kopje të strukturës së re të AZHBR-së (pas ndryshimit), ku të pasqyrohen kriteret e kërkuara dhe detyrat për të njëjtin pozicion.
- Kopje të kërkesë-padisë së ankueses drejtuar gjykatës.
- Nëse ka një vendim gjykate lidhur me gjykimin e çështjes në fjalë, ju lutemi të sillni bashkëngjitur një kopje të këtij akti.

Me shkresën nr.984/3 prot., datë 14.05.2018 AZHBR ka depozituar pranë Komisionerit dokumentacionin poshtëcituar:

- Kopje e vendimit të Ristrukturimit nr.277 prot., datë 30.01.2018.
- Kopje të strukturës së vjetër të AZHBR-së, bazuar në Urdhërin e Kryeministrit nr.156, datë 01.12.2015 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AZHBR-së”.
- Kopje të strukturës së re të AZHBR-së, bazuar në Urdhërin e Kryeministrit nr.190, datë 06.11.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AZHBR-së”.
- Kopje të kërkesë-padisë me nr.akti 1718, datë 20.02.2018. të regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, çështje e cila është ende në proces gjykimi.

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes së znj.Sh, Komisioneri me datë 14.06.2018 realizoi një seancë dëgjimore.

⁷Nga dokumentacioni i depozituar në dosje, rezulton se znj.J.Sh ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Ekonomisë, pranë UT-së, në vitet 1981-1985, në sistemin me shkëputje nga puna.

Në seancë ishin të pranishëm përfaqësues të të dyja palëve në proces. AZHBR-ja me shkresën me nr.1954/1 prot., datë 13.06.2018 autorizonte znj.B K dhe znj.R V të përfaqësonin institucionin; ndërsa pala ankuese përfaqësohej nga av.A P, duke qenë dhe personalisht e pranishme. Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Nga ana e palës ankuese u pretendua se ka patur diskriminim nga ana e AZHBR-së pikërisht për shkak të bindjeve të saj politike, të kundërta me ato të drejtuesve të institucionit, edhe pse ajo vetë nuk kishte bindje politike por nga ana e drejtuesve të institucionit mund të prezumohej për të kundrëtën. Ankuesja pretendoi edhe për diskriminim për shkak të gjendjes së saj arsimore, pasi në bindjen e saj ajo e përmbush dhe kriterin arsimor të kërkuar për pozicionin e punës që kishte si Drejtore e Drejtorisë së Ekzekutimit të Pagesave. Përfaqësueset me autorizim të AZHBR-së, i qëndruan të njëjtës linjë argumentimi sikurse kishin informuar Komisionerin edhe më parë gjatë komunikimit shkresor; që në asnjë moment znj.Sh nuk është diskriminuar për shkaqet e pretenduara dhe se ajo ishte larguar vetëm për shkak të ndryshimit të strukturës së institucionit. Me miratimin e kësaj strukture janë ndryshuar edhe kriteret arsimore të pozicionit të punës që kishte ankuesja, gjë që përfaqësueset e AZHBR-së e cmojnë si diskrecion të vetë institucionit, dhe ajo është larguar vetëm për faktin se nuk përmbushte këtë kriter. Ato theksuan faktin se në dokumentacionin e sjellë prej tyre, me kërkesë të KMD-së, provohet fakti se nëpunësja e emëruar në pozicionin që mbante ankuesja e përmbush kriterin arsimor të miratuar në strukturën e re; duke hedhur poshtë faktin e pretenduar nga znj.Sh për të kundrëtën. Ato cituan edhe faktin se pretendimin për largim të padrejtë nga puna, ankuesja e ka bërë edhe objekt të shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila në përfundim të shqyrtimit të saj vendosur rrëzimin e saj si të pabazuar në ligj dhe prova.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave gjatë shqyrtimit të çështjes nga Komisioneri.

A. Lidhur me pretendimin e ankueses për trajtim të pabarabartë dhe të pafavorshëm nga ana e AZHBR-së.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e znj.Sh, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të pabarabartë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrativ⁸, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast AZHBR-së. Pra, në këtë rast AZHBR duhet të provontë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshme, për shkakun e pretenduar prej saj.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Nga këqyrja e dokumentacionit të grumbulluar gjatë shqyrtimit të çështjes, rezulton se, ankuesja ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Ekzekutimit të pagesave, në AZHBR, që prej datës 27.11.2013 deri në datën 01.02.2018 kur është liruar nga shërbimi civil⁹.

Me urdhërin nr.190, datë 06.11.2017 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AZHBR (Agjencia e Pagesave)”, rezulton se është miratuar struktura e AZHBR dhe punonjësit e saj i janë nënshtruar procesit të ristrukturimit.

Me urdhërin nr.123, datë 07.12.2017 të DAP, në zbatim të nenit 50 të ligjit nr.152”Për nëpunësin civil” është ngritur komisioni i Ristrukturimit në AZHBR (Agjencia e Pagesave).

Komisioni i Ristrukturimit, ka shqyrtuar këto dokumentacione:

- Strukturën dhe organikën ekzistuese të AZHBR.
- Strukturën dhe organikën e re të AZHBR.
- Të dhënat individuale (dosjen personale) të nëpunësit civil, Znj.Sh.

⁸Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

⁹Referuar vendimit nr.277 prot., datë 30.01.2018, të Komisionit të Ristrukturimit të AZHBR-së “Për lirimin nga shërbimii civil të Znj. Enida Shena për shkak të ndryshimit të kriteve të vëndit të punës”.

- Kriteret specifike të vendeve të lira, të prekura, si pasojë ristrukturimi.

Lidhur me sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se znj.Sh nuk përmbushte kriterin arsimor/profesional lidhur me pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë të Ekzekutimit të Pagesave, pasi nuk plotësonte kriteret e vecanta të punës për këtë pozicion. Konkretisht, kriterin e arsimit “Arsim i Lartë Universitar në Shkenca Ekonomike, Master Shkencor dhe Bachelor të jenë në të njëjtën fushë, pasi ajo rezulton se zotëron diplomat: Master i Shkencave në degën Gjeografi, në Fakultetin e Histori-Filologji-së/UT, Master Profesional në degën Teknologji të Avancuara në Hortikulturë, në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, në Universitetin Bujqësorë të Tiranës, si dhe Master Profesional në degën Ekonomi dhe Agrobiznes, profili Ekonomi dhe Politikë Agrare, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit/UBT.

Kriteri tjetër i kërkuar ishte kriteri i përvojës “Mbi 5 vjet përvojë pune në profesion si Ekonomiks, Financier, Kontabilist dhe jo me pak se 3 vjet përvojë pune në nivel të ulët drejtues”.

Referuar shkreses nr.17416 prot., datë 01.12.2017 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, drejtuar DAP-it si dhe ligjit nr.10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, periudha kalimtare 2 vjecare për plotësimin e kërkesave ligjore për nëpunësit zbatues ka përfunduar.

Lidhur mësa më sipër dhe nga verifikimi i dosjes së Znj.Sh, rezulton se ajo nuk i plotëson kriteret ligjore për të qënë nëpunës zbatues:

- Të këtë përfunduar studimet e ciklit të dytë në Shkencat Ekonomike ose Diplomë Universitare të ekuivalentuar më të (Bachelor dhe Master në të njëjtën fushë).
- Të këtë përvojë pune jo me pak se 5 vjet në profesion.

Pra, Znj.Sh, nuk plotëson kriteret e veçanta për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Ekzekutimit të Pagesave.

Ligji “Për Nëpunësin Civil” kërkon si domosdoshmëri emerimin e nëpunësit në të njëjtin pozicion dhe jo në një pozicion më të ulët se ai për të cilin është konfirmuar nga DAP-i.

Komisioni i Ristrukturimit, me vendimin nr.277, datë 30.01.2018, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për Znj. E Sh, për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Në zbatim të këtij vendimi, Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR, ka nxjerrë urdhërin nr.80 prot., datë 01.02.2018, për ndërprerjen e marrëdhënies financiare për ankuesen, për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Bazuar në procedurën e ristrukturimit dhe dokumentacionin e disponuar në dosje, Komisioneri, vlereson se vendimi i Komisionit të Ristrukturimit të AZHBR-së për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të Znj. E Sh është marrë konform dhe në zbatim të ligjit “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve të tjera nënligjore nën zbatim të tij.

Neni 19, i ligjit “Për Nëpunësin Civil”, parashikon se pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit dhe bazohet në përshkrimin e punës për çdo pozicion¹⁰.

Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar të gjitha mundësitë për sistemimin e Znj.Sh në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori dhe ka konkluduar se nuk ka qenë i mundur transferimi për shkak të mospërbushjes së kriterëve të veçanta të përshkrimeve të punës të pozicioneve të reja të krijuara pas ristrukturimit të institucionit. Pra, janë konsideruar jo vetëm kriteret e vecanta, por edhe përshkrimi ekzistues në të cilin znj.Sh ka qenë e punësuar, duke krahasuar kriteret dhe përshkrimet e punës së pozicioneve të reja apo pozicioneve vakante, në shërbimin civil, sipas database-t të vënë në dispozicion nga DAP-i; fakt ky i vërtetuar dhe gjyqësisht¹¹.

Udhëzimi nr.1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të Institucionit”, ka përcaktuar procedurën për krijimin e funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, në kushtet kur institucioni ndodhet në kushtet e ristrukturimit; pra ndryshimit të brendshëm të institucionit, si dhe në kushtet e riorganizimit të tij.

Lidhur me sa mësipër, Komisioneri konstaton se Komisioni i Ristrukturimit pranë AZHBR-së është ngritur konform dhe në zbatim të procedurës së parashikuar nga ligji dhe nënligjore të dala për zbatimin e tij, dhe se ka vepruar në përputhje me diskrecionin që i është dhënë atij kur ka vlerësuar se znj.Sh nuk përmbush kriteret e veçanta të përshkrimit të punës, të kërkuar për pozicionin e Drejtores së Drejtorisë së Ekzekutimit të Pagesave, pas ristrukturimit të institucionit; si dhe pamundësinë e transferimit të saj në një pozicion pune tjetër të së njëjtës kategori në AZHBR për shkak të arsimit të saj mjaft specifik. DAP-i ka konfirmuar se, në institucionet e shërbimit civil janë shumë të pakta pozicionet e punës me këto fusha arsimit, si të ankueses, ndër të cilat, nga verifikimi i kryer nga Komisioni i Ristrukturimit dhe DAP-i, asnjë prej tyre nuk rezulton të jetë vakant.

Për sa më sipër Komisioneri vlerëson se në rastin konkret nuk jemi përpara rastit të paligjshmerisë nga ana e komisionit të Ristrukturimit të AZHBR-së dhe se vendimi përfundimtar për lirim nga shërbimi civil i Znj.Sh është marë në përputhje me procedurat, kompetencat ligjore dhe diskrecionin që i është dhënë nga ligji.

Përsa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se AZHBR-ja, nuk e ka ekspozuar ankuesen ndaj një trajtimi të paligjshëm dhe të padrejtë.

¹⁰ Ankuesja bënte pjesë në kategorinë e mesme drejtuese, II-b. Rezulton e provuar se për këtë kategori së cilës i përkiste ajo, numri i mëparshëm i punonjësve ishte 250 punonjës dhe pas miratimit të strukturave të reja ka shkuar në 183. Pra, rezultoni e provuar se ka një shkurtrim me 67 pozicione pune të nivelit të njëjtë me atë të ankueses.

¹¹ Reruar vendimit nr.2235, datë 11.06.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin¹² 2 të ligjit nr. 10221, datë 02.04.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se subjekti ankues i pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, znj.Sh, ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë diskriminuese për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes arsimore.

1. Sa i përket bindjeve politike

Ankuesja pretendon diskriminim për shkak të bindjeve politike, por gjatë trajtimit të ankesës nuk ka vënë në dispozicion asnjë provë a dokument për të vërtetuar aktivitetin apo bindjet politike të saj. Të njëtin qëndrim ka mbajtur dhe gjatë seancës dëgjimore përmes përfaqësuesit me prokurë, av.P i cili parashtrroi se drejtuesit e institucionit mund të prezumonin se ajo kishte bindje të kundërta me to, megjithëse ajo nuk kishte bindje politike të ekzizuara.

Në këto kushte, Komisioneri konstaton pala ankuese nuk ka paraqitur provat dhe argumentimet e nevojshme, të cilat të krijojnë bindjen se vërtetohet shkaku i pretenduar, pavarësisht pretendimit të saj.

2. Sa i përket gjendjes arsimore

Ankuesja pretendon diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, pasi është zëvendësuar me një punonjëse, e cila ka nuk ka arsimin e kërkuar, sipas kriterëve të vendosura në strukturën e re të AZHBR-së.

¹² Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Gjatë trajtimit të ankesës së znj.Sh, u administrua një kopje e dosjes së saj, ku konstatohet se ankuesja zotëron diplomën: “Master i Shkencave” (sistemi 4-vjeçar) në degën Gjeografi, në Fakultetin e Histori-Filologjisë, në UT; Master Profesional në degën “Teknologji të Avancuara në Hortikulturë”, në fakultetin e Bujqësisë së Mjedisit, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, si dhe Master Profesional në degën “Ekonomi dhe Agrobiznes”, profili Ekonomi dhe Politikë Agrare, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Përsa më lart, ankuesja ka paraqitur prova dhe fakte, për të vërtetuar shkakun e pretenduar të gjendjes arsimore.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar se faktin se ankuesja është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e AZHBR-së, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹³ dhe trajtimit të pafavorshëm të ankueses.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga AZHBR-ja, gjatë shqyrtimit të ankesës, u konstatua se punonjësja e emëruar në vend të subjektit ankues, në pozicionin e Dejtores së Drejtorisë Ekzekutimit të Pagesave, referuar shkresës me nr.531/56 prot., datë 15.02.2018 të DAP-it, ishte znj.Jo Sh. Nga këqyrja e dokumentacionit të dosjes së saj, rezulton se ajo ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin Ekonomik, të Universitetit të Tiranës “Enver Hoxha” dhe zotëron titullin Ekonomist¹⁴. Po ashtu ajo zotëron dhe: “Çertifikatë për Sistemin e Informacionit dhe menaxhimit financiar të likuiditeteve të Qeverisë-Komisioni Europian/Ministria e Financave. “Çertifikatë trajnimi për kontrollin administrative dhe on-spot kontroll për skemat e IPARD-it. (Mbështetja institucionale për zhvillimin bujqësor dhe rural). “Çertifikatë trajnimi për monitorimin, prokurimet dhe menaxhimin financiar të Projekteve të Bankës Botërore”, “Çertifikatë trajnimi për monitorimin e Projekteve të Bankës Botërore”, si dhe trajnime të përditesuara nga Banka Botërore dhe Ministria e Financave për monitorimin, menaxhimin financiar dhe standartet e prokurimeve. Pra, konstatohet se Znj.Sh plotëson kriterin arsimor dhe profesional të kërkuar për këtë pozicion pune, sipas përshkrimit të punës në strukturën e re të AZHBR-së, miratuar me urdhërin nr.190, datë 06.11.2017, të Kryeministrit. Për rrjedhojë, bie poshtë pretendimi i ankueses për të kundërtën.

Në këto kushte, duke analizuar dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës, shpjegimet e dhëna nga palët, si dhe legjislacionin përkatës lidhur me sa më sipër, Komisioneri nuk arriti të administrojë prova për të vërtetuar që të ketë patur veprime të paligjshme apo trajtim të pa favorshëm të ankueses nga ana e AZHBR-së, krahasuar me

¹³ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

¹⁴ Referuar Diplomës me nr.5075, datë 10.07.1985 të Universitetit të Tiranës “Enver Hoxha”.

punonjësen që e ka zëvendësuar atë, lidhur me shkaqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/a), b), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj.E Sh, nga ana e AZHBR-së, për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes arsimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(shkaku: gjendja arsimore, bindje politike)

(fusha: punësim)